

AKT THEMELIMI

PER SHOQERINE "SARK" SH.P.K. FIER

Ne Fier, sot me daten 26-11-2004, ne ortaket Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj, banuesa ne qytetin e Fierit, konform ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", bejme kete akt themelimi:

Me vullnetin tone te lire themelojme shoqerine me emertimin "SARK" sh.p.k. me seli ne Lagjen "8 shkurti" Fier, pra shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortake Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj..

Themeluesat e kesaj shoqerie jane ortaket Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj..

Selia dhe qendra e kesaj shoqerie eshte lagjen "8 shkurti" Fier.---

Vula e shoqerise permban "SARK" shpk FIER .--

Krijohet me mjetet financiare prone e ortakeve Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj. ne masen 100%, (ku secili prej ortakeve zoteron ne pjese te barabarta 50% te kapitalit te shoqerise.) ne shumen prej 100 000 (njqind mije) leke.

Kjo shoqeri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nenshtrohet legjislacionit perkates shqiptar.

Afati i veprimtarise se saj do te jete mbi dhjete vjet kohe. Ky afat mund te zgjatet dhe mund te shkurtohet ne rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe pasyqrohen ne statut.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Import-eksport, tregetim me shumice dhe pakice te mallrave farmaceutike barnash mjekesore, materiale me perdorim dentar, klinike mjekesore etj.

-Veprimatri private ne fushen ndertimit, te banesave, objekteve industriale, vepra bonifikimi, ndertime ne fushen e ujesjelles-kanalizimeve, ndertim rrugeshe te kategorive te ndryshme

-Veprimtari private ne fushen e tregetise me shumice e pakice, import-eksport te materialeve te ndryshme, mallrave industriale, prodhim materialeve ndertimi, prodhim e tregetim mobiljesh, dyer, dritare, tregetim te lendeve te para per industrine, materiale plastike, duraluminit, metaleve, lendeve te ndertimit, pjeseve te kembimit te mjeteve, makinerive e pajisjeve, hidrosanitare, elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, mallrave ushqimore, bimeve mjekesore e medicinale, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, bar-bufe, restorant, hoteleri, servis makinash, lavazho etj.

Organ vendimor ne shpk "SARK" shpk eshte Asambleja e Ortakeve qe thirret ne séance te zakonshme te pakten nje here ne vit dhe drejtohet nga administratori i shoqerise. Asambleja merr vendime te zakonshme dhe te jashtzakonshme sipas dispozitave ligjore te percaktuara ne statut.

Shoqeria administrohet nga administratori i cili mund te jete nje nga ortaket, te dy se bashku, ose nje person tjeter. Kopetencat e administratorit percaktohen ne statut. Me themelimin e ketij akt, administratore te shoqerise caktohen te dy ortaket Arben Kajolli




dhe Sokrat Koçiaj, te cilet kane te drejte qe veprojne te dy se bashku ose vetem njeri sipas mundesise, me tagra dhe kopetenca te plota.

Ne kete shoqeri mund te aderojne ortakete te tjere te rinj ne kushtet qe do te percaktohen ne akt marreveshjen e bere ne rastin e pranimit te tyre.

Po ashtu ortaketet kane te drejten te ndryshojne apo shtojne objektin e veprimtarise se shpk "SARK" Fier, sipas interesave te veta ekonomike dhe financiare.

Shpk "SARK" shpk ka te drejte te punesoje specialiste te fushes qe i perket objektit te veprimtarise si dhe punonjes te tjere me kontrate pune sipas percaktimeve ne Kodin e Punes dhe pergjithesisht me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Do te konsiderohen veprimtari te shoqerise vetem ato veprime juridiko-civile qe do te kryhen nga organet e saj konform disponimeve ne statutin dhe ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Si rregull veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, perjashtim nga ky rregull do te behet kur kerkon organi kopetent ligjor.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakut te vetem, administratorit dhe personave te tjere te punesuar ne shoqeri, ne rast se nuk zgjidhen me pajtim do te zgjidhen nga gjykata kopetente.

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i ligjshem i kesaj shoqerie tregtare eshte ne favor te ortakëve te shoqerise ne masen 50%secili.

Nderkohe ortaketet mbartin mbi vehte rrezikun e humbjes deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve (ne masen 50% secili ortak).---

Per detyrimet qe shoqeria mund t'ju kete personave te tjere juridike apo fizike pergjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.

Per funksionimin normal te shoqerise do te hartohet statuti i shoqerise "SARK" SHPK ku do te parashikohen hollesite e mirefunksionimit dhe administrimit te saj.

Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

Kjo shoqeri mund te mbyll aktivitetin e vet ne rastet e parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe ne statutin e saj.

Shoqeria "SARK" shpk do te marre personalitet juridik me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nje kopje e akti i themelimit se bashku me statutin e shoqerise "SARK" Fier, ruhen ne ate gjyakate.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "SARK" shpk

Arson Kojoli
Lid

Sokrat Koçiaj
Lid



STATUT

PER SHOQERINE "SARK" SH.P.K. FIER

Ne ortaket e shpk "SARK" me qender ne Fier, ARBEN KAJOLLI dhe SOKRAT KOÇIAJ, mbeshtetur ne ligjin 7638 dt 19-11-1992 "Per shoqerite tregetare" dhe ne akt-themelimin e shoqerise "SARK" Shpk Fier, te dates 26-11-2004, si ortake dhe themelues te saj hartojme statutin e kesaj shoqerie:

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 1

Shoqeria "SARK" eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me statusin e personit juridik shqiptar.

NENI 2

Emertimi i shoqerise eshte "S A R K" shpk e krijuar me akt-themelimin e ortakeve Arben Kajolli dhe Sokrat Kociaj, me mjetet e tyre financiare.

NENI 3

Qendra dhe selia e shoqerise eshte ne Lagje "8 shkurti" te qytetit Fier. Vula e shoqerise ka kete permbajtje: "S A R K" shpk FIER.---

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:


-Import-eksport, tregetim me shumice dhe pakice te mallrave farmaceutike barnash mjekesore, materiale me perdorim dentar, klinike mjekesore etj.

-Veprimatri private ne fushen ndertimit, te banesave, objekteve industriale, vepra bonifikimi, ndertime ne fushen e ujesjelles-kanalizimeve, ndertim rruges te kategorive te ndryshme

-Veprimtari private ne fushen e tregetise me shumice e pakice, import-eksport te materialeve te ndryshme, mallrave industriale, prodhim materialesh ndertimi, prodhim e tregetim mobiljesh, dyer, dritare, tregetim te lendeve te para per industrine, materiale plastike, duraluminit, metaleve, lendeve te ndertimit, pjeseve te kembimit te mjeteve, makinerive e pajisjeve, hidrosanitare, elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, mallrave ushqimore, bimeve mjekesore e medicinale, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, bar-bufe, restaurant, hoteleri, servis makinash, lavazho etj

NENI 5

Ky objekt veprimtarie, mund te shtohet, pakesohet apo ndryshohet me vendimin e ortakeve te shoqerise.



MJETET E SHOQERISE

NENI 6

Shoqeria "SARK" shpk, per fillimin e veprimtarise se saj ka nje kapital fillestar prej 100 000 leke, te ndara keto ne dy pjese, nga 50% per secilin ortak. Ky kapital eshte i shlyer plotesisht dhe nenshkruar nga dy ortaket.

NENI 7

Me mjetet e shoqerise, kuptohen edhe ato objekte, sende dhe te holla qe do te fitohen ne te ardhmen nga ushtrimi i veprimtarise se kesaj shoqerie.

NENI 8

Per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve ndaj shtetit dhe personave te trete, juridike apo fizike, si edhe per te shtuar veprimtarine e saj, shoqeria, krijon nje fond rezerve prej 1/20 e fitimit te vitit paraardhes financiar.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 9

- Organi me i larte drejtues, eshte Asambleja e Ortakeve.
 - Shoqeria administrohet nga administratori.
 - Administratore te shoqerise jane te dy ortaket Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj
- Vendimet qe merr njeri administrator kane te njejten vlere si vendimet e marra nga te dy administratoret se bashku.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 10

Asambleja e ortakeve funksionon me Mbledhjet e Asamblese se Zakonshme dhe Jashtzakonshme. Mbledhjet e Asamblese se Zakonshme thirren te pakten nje here ne vit.


Thirrjet e Asamblese behen me njoftime me shkrim, qe permbajne rendin e dites, vendin dhe oren e Mbledhjes, derguar secilit ortak te pakten 10 dite para ose ne rast urgjent 2 dite para. Administratori duhet te njoftoje gjithashtu Asamblene brenda 5 diteve kur ka marre kerkese nga ortaket ose njeri prej tyre, qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqerise dhe ne keto kerkesa tregohen ceshtjet qe duhen trajtuar.

Asambleja drejtohet nga administratori i shoqerise ne qofte se ajo nuk vendos ndryshe. Administratori emerone nje sekretar per te mbajtur procesverbalin. Secili ortak mund te perfaqesohet me prokure te posacme me akt noterial nga nje person tjetër qe nuk eshte ortak.

VENDIMET E ASAMBLESE

NENI 11

- Asambleja merr keto vendime te zakonshme:
- Miraton statutin e shoqerise dhe rregulloren e brendshme te saj.
 - Emerone administratorin e shoqerise.
 - Vendos dhe analizon veprimtarine ekonomike-financiare te shoqerise.
- Asambleja merr vendime te jashtzakonshme si:

- 
- Ndryshimin e statutit te shoqerise dhe akt-themelimit.
 - Emerimin e personave te ngarkuar per likuidim.

ADMINISTRATORI

NENI 12

Administratori kur largohet perkohesisht, vendos me shkrim zevendesin e tij, duke i percaktuar qarte dhe ne menyre konkrete detyrimet dhe kopetencat qe ai mban per ate periudhe mungese.

Zevendesi nuk ka te drejte te dale jashte tagrave te dhena.

Administratori ka kopetenca te veproje ne marredhenie me te tretet, te perfaqesoje shoqerine ne raporte me persona te tjere juridike ose fizike, publike ose private, bankat, etj.

Administratori nenshkruan dhe jep urdhera per veprimet financiare te shoqerise, emeron punonjesit e thjeshte teknike te shoqerise, nenshkruan listpagesen e punonjesve, urdheron dhenien e dietave per punonjesit ose shperblim e stimuj per persona te tjere jashte saj qe veprojne per llogari te kesaj shoqerie.

Administratori ka te drejte te marre vendime dhe te nxjerre urdhera ne funksion te veprimtarise qe zhvillon shoqeria sipas kopetencave te dhena nga statuti dhe ligji per shoqerite tregetare.

Administratori caktohet per nje periudhe kohe trevjecare me te drejte riemerimi.

Asambleja e zakonshme dhe e jashtzakonshme krijohet ne rastin e pare te takimit me prezencen e ortakeve, te cilet vendosin ne menyre te vlefshme me vota por me ao ortake sa te perfaqesohet shumica absolute e kapitalit themeltar.

FITIMI DHE NDARJA E TIJ

NENI 13

Pasi paguhen detyrimet, si taksa, tatime, shpenzime te tjera te domosdoshme, pagat e punonjesve te shoqerise, mbetet fitimi neto, i cili eshte ne favor te ortakeve te shoqerise Arben Kajolli dhe Sokrat Koçiaj. Ne masen 50% secili ortak. Ortaket mbartin mbi vete rrezikun e falimentimit deri ne masen 100 % te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

NENI 14

Me vendim te ortakeve te shoqerise kjo shoqeri mund te cele filiale ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERINE "SARK"

NENI 15

Ne shoqerine "SARK" shpk, mund te futen ortake te tjere te rinj, ne kushtet qe percaktohen ne kontraten e bere me kete rast, sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.

NENI 16

Per punonjesit e tjere te shoqerise behen kontrata kolektive dhe individuale te punes, sipas parashikimeve ne legjislacionin shqiptar te punes.



NENI 17

Punonjesi i shoqerise pergjigjet disiplinarisht, materialisht dhe penalisht nese eshte rasti, kur shkel detyrimet e veta sipas kontrates se punes, per demet qe mund t'i sjelle shoqerise me veprimet ose mosveprimet e tij te fajshme.

KOHEZGJATJA DHE MBYLLJA E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria "SARK" shpk, krijohet per te ushtruar aktivitetin me nje afat kohor mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme.

NENI 19

Kjo shoqeri mbyllet sipas parashikimeve te bera ne legjislacionin shqiptar dhe atyre te parashikuara ne statutin e vet.

DISPOZITA TE FUNDIT


NENI 20

Shoqeria "SARK" shpk merr personalitet juridik me rregjistrimin ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Shkalles se Pare te rrethit Tirane.

NENI 21

Nje kopje e ketij statuti dhe nje kopje e akt-themelimit se bashku me vendimin depozitohen ne Gjykaten e Shkalles se Pare te rrethit Tirane.

ORTAKET THEMELUES

Arben Kajoll,


Sokrat Kociq,
